


Vendime të marra gjatë seancës plenare, 23 shtator 2020



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Pas diskutimeve mbi draftin e përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli ka miratuar në unanimitet “Rregulloren mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e Drejtuesit në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”. Kjo rregullore përbën një hap vendimtar në drejtimin e ndërprerjes së caktimeve të përkohshme të prokurorëve në pozicione drejtuese, si një instrument i nevojshëm që është përdorur nga Këshilli për rreth një vit e gjysmë për plotësimin e vakancave të shkaktuara si rrjedhojë të vendimeve të institucioneve të Vetting-ut dhe jo vetëm.

Miratimi i kësaj rregullore i hap rrugë procesit të konkurrimit në bazë të meritokracisë të prokurorëve në pozicione drejtuese. Ky është nga proceset më të rëndësishme të përmbyllura nga Këshilli, që sikur se përmendem më lart, i jep fund procedurës së caktimit të përkohshëm të drejtuesve të prokurorëve, i cili në jo pak raste, ka qenë një zgjedhje në kushte emergjence dhe jo mbi bazën e konkurrimit mbi kriteret të paracaktuara duke shkaktuar pa kënaqësi të natyrshme në radhën e prokurorëve.